



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-CC-2025-31

**Vendosi:** Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese  
Gjykatës Vidar Stensland, Kryetar  
Gjykatës Rumen Nenkov  
Gjykatës Pjotr Hofmanski

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 5 shkurt 2026

**Gjuha:** Anglishte

**Emri i dosjes:** Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Hashim Thaçi

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendim mbi Kërkesën Referuese të Hashim Thaçit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të Drejtat Themelore**

---

**Parashtruesit**  
Hashim Thaçi

**Prokurores së Specializuar**  
Kimbërli P. Uest

I.	PROCEDURA .....	3
A.	KËRKESA REFERUESE.....	3
B.	PARASHTRIMET ME SHKRIM DHE GJUHA E PUNËS.....	4
C.	SHQYRTIMI I KËRKESËS REFERUESE.....	4
II.	FAKTET .....	5
A.	CAKTIMI I GJYKATËSIT TË VETËM SIPAS NENIT 33(2) TË LIGJIT .....	5
B.	ÇËSHTJA PËR KRIME KUNDËR NJERËZIMIT DHE KRIME LUFTE.....	5
C.	AUTORIZIMI GJYQËSOR I KËRKESAVE TË ZPS-SË.....	6
D.	CAKTIMI I GJYKATËSIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE DHE PARASHTRIMI I AKTAKUZËS .....	7
E.	CAKTIMET E REJA GJYQËSORE.....	9
F.	SHQYRTIMI DHE RISHIKIMI I MËTEJSHËM I AKTAKUZËS.....	9
G.	KONFIRMIMI I AKTAKUZËS .....	9
H.	MOCIONET PARAPRAKE DHE PROCEDURA E APELIT TË NDËRMJETËM .....	12
I.	KALIMI PËR GJYKIM I ÇËSHTJES NË LIDHJE ME ADMINISTRIMIN E DREJTËSISË.....	15
III.	SHKELJET E PRETENDUARA.....	16
IV.	JURIDIKSIONI .....	17
V.	KUADRI I SHQYRTIMIT.....	17
VI.	PRANUESHMËRIA.....	21
A.	PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 31(2) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 6(1) TË KONVENTËS .....	22
1.	Parashtrimet.....	22
2.	Vlerësimi i Dhomës.....	24
B.	PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 36 TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 8 TË KONVENTËS .....	28
1.	Parashtrimet.....	28
2.	Vlerësimi i Dhomës.....	29
C.	PËRFUNDIM.....	30

## Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese

E përbërë nga

Vidar Stensland, Kryegjykatës

Rumen Nenkov, gjykatës

Pjotr Hofmanski, gjykatës

Pas kuvendimit përmes lidhjes nga distanca, lëshon këtë Vendim

### I. PROCEDURA

#### A. KËRKESA REFERUESE

1. Më 29 dhjetor 2025, z. Hashim Thaçi ("Parashtruesi") paraqiti një kërkesë referuese në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ("Kushtetuta") dhe nenit 49(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Dhoma" dhe "Kërkesa Referuese").<sup>1</sup> Parashtruesi përfaqësohej nga Sofi Menegon dhe Luka Mishetiq.

2. Në Kërkesën Referuese, Parashtruesi ankohet për shkelje të të drejtave themelore të tij në lidhje me procesin penal kundër tij që po zhvillohet në Dhomat e Specializuara ("DHS"). Në veçanti, Parashtruesi pretendon se caktimi i Gjykatësit të Vetëm, i cili autorizoi masa hetimore të posaçme ("MHP") dhe masa të tjera ndaj tij në kuadër të KSC-BC-2018-01 ("dosja hetimore"), dhe caktimi më pas i të njëjtit gjykatës si Gjykatës i Procedurës Paraprake në procesin penal kundër tij në çështjen KSC-BC-2023-12 ("Çështja 12") nuk ishin bërë në përputhje me ligjin, duke shkelur rrjedhimisht të drejtën e tij që për akuzat penale kundër tij të vendosë një "gjykatë e themeluar me ligj" sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës Evropiane për

---

<sup>1</sup> KSC-CC-2025-31, F00001, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Hashim Thaçi, publike, 29 dhjetor 2025.

Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”).<sup>2</sup> Parashtruesi pretendon gjithashtu shkelje të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare sipas nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të Konventës si pasojë e masave hetimore të posaçme dhe masave të tjera të autorizuara nga gjykatësit në fjalë.<sup>3</sup>

3. Më 30 dhjetor 2025, Kryetarja e DHS-së (“Kryetarja”), caktoi panelin e lartpërmendur për të vendosur në lidhje me kërkesën referuese në bazë të nenit 33(3) të Ligjit.<sup>4</sup>

#### B. PARASHTRIMET ME SHKRIM DHE GJUHA E PUNËS

4. Dhoma vlerësoi se Kërkesa Referuese ishte mjaftueshmërisht e plotë dhe se nuk nevojiteshin parashtrime të tjera me shkrim sipas rregullës 15(2) të Rregullores së Punës së Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese (“Rregullorja e DHSGJK-së”).

5. Gjithashtu, në bazë të nenit 20 të Ligjit dhe rregullës 5 të Rregullores së DHSGJK-së, Dhoma vendosi që gjuha e punës në këtë proces gjyqësor të ishte anglishtja, me përkthim zyrtar të ofruar nga Zyra Administrative në dy gjuhët e tjera zyrtare të DHS-së, përkatësisht në shqipe dhe në serbishte.

#### C. SHQYRTIMI I KËRKESËS REFERUESE

6. Dhoma do të bëjë shqyrtimin e Kërkesës Referuese, bazuar në vetë Kërkesën Referuese dhe dokumentet e cituara në të. Ky vendim u referohet atyre fakteve të çështjes dhe parashtrimeve të Parashtruesit që janë relevante për vlerësimin e Kërkesës Referuese nga Dhoma.

---

<sup>2</sup> Kërkesa Referuese, para. 3, 29-78.

<sup>3</sup> Kërkesa Referuese, para. 3, 79-84.

<sup>4</sup> KSC-CC-2025-31, F00002, Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese, publik, 30 dhjetor 2025. Lidhur me vendin e zhvillimit të procedurave, shih KSC-CC-2019-06, F00001, Kërkesë për Ndryshimin e Vendit të Zhvillimit të Procedurës në lidhje me Referimet e Parashtruara në përputhje me Nenin 49 të Ligjit, publik, 18 janar 2019; F00002, Vendim për Vendin e Zhvillimit të Procedurave para Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 22 janar 2019.

## II. FAKTET

### A. CAKTIMI I GJYKATËSIT TË VETËM SIPAS NENIT 33(2) TË LIGJIT

7. Më 29 maj 2018, në vijim të kërkesës së paraqitur nga Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), Kryetarja, në bazë të nenit 33(2) të Ligjit, caktoi gjykatësin Nikola Giju ("gjykatësi Giju") si gjykatës të vetëm "si gjykatës të vetëm për shqyrtimin e çfarëdo kërkesë për autorizim gjyqësor dhe çështje të lidhura me to, parashtruar nga Prokurori i Specializuar para ngritjes së aktakuzës dhe caktimit në vijim të një gjykatësi të procedurës paraprake sipas nenit 33(1)(a) të Ligjit".<sup>5</sup> Në lidhje me këtë, vendimi i caktimit përcakton se (i) "caktimet sipas nenit 33(2) të Ligjit janë me natyrë të përkohshme dhe pushojnë sapo të jetë zgjidhur çështja për të cilën janë bërë ato caktime", konkretisht lidhur me "çfarëdo kërkesë për autorizim gjyqësor e parashtruar nga Prokurori i Specializuar para ngritjes së aktakuzës" në çështjen në fjalë,<sup>6</sup> dhe (ii) "për të siguruar zgjidhjen e shpejtë dhe efikase të këtyre kërkesave, gjykatësi i vetëm caktohet edhe për shqyrtimin e të gjitha kërkesave të ardhshme".<sup>7</sup> Vendimi përcakton gjithashtu se në përputhje me nenin 33(4) të Ligjit, gjykatësi vetëm i caktuar "nuk mund të jetë anëtar i panelit në një fazë tjetër të së njëjtës çështje, përveçse si gjykatës i procedurës paraprake".<sup>8</sup>

### B. ÇËSHTJA PËR KRIME KUNDËR NJERËZIMIT DHE KRIME LUFTE

8. Më 26 tetor 2020, gjykatësi Giju, si Gjykatësi i Procedurës Paraprake i caktuar nga Kryetarja në çështjen KSC-BC-2020-06 ("Çështja 06"),<sup>9</sup> konfirmoi aktakuzën e dorëzuar nga ZPS-ja kundër Parashtruesit,<sup>10</sup> ku paraqiti kundër tij dhe tre të

---

<sup>5</sup> KSCPR-2018, F00004, Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm sipas Nenit 33(2) të Ligjit, 29 maj 2018, publik ("Vendimi për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm"), Vendimi.

<sup>6</sup> Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm, para. 15.

<sup>7</sup> Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm, para. 16.

<sup>8</sup> Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Vetëm, para. 18.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-06, F00001, Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, 23 prill 2020, publik, Vendimi.

<sup>10</sup> Shih KSC-BC-2020-06, F00045/A03, Shtojca 3 e Parashtrimit të Versioneve të Korrigjuara dhe të Redaktuara Publike të Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave lidhur me Të.

akuzuarve të tjerë, gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit dhe katër akuza për krime lufte, që pretendohet të jenë kryer midis së paku marsit 1998 dhe shtatorit 1999 në Kosovë dhe në pjesë të Shqipërisë veriore.<sup>11</sup>

9. Më 5 nëntor 2020, në bazë të fletarrestimit dhe urdhrit për transferim të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 26 tetor 2020,<sup>12</sup> Parashtruesi u arrestua në Kosovë dhe u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së në Hagë, Holandë,<sup>13</sup> ku vazhdon të jetë në paraburgim gjatë gjykimit.

10. Procesi gjyqësor në Çështjen 06 filloi më 3 prill 2023<sup>14</sup> dhe ende vazhdon.

#### C. AUTORIZIMI GJYQËSOR I KËRKESAVE TË ZPS-SË

11. Më 31 mars 2023, gjykatësi Giju, në cilësinë e Gjykatësit të Vetëm të caktuar nga Kryetarja sipas nenit 33(2) të Ligjit,<sup>15</sup> miratoi një kërkesë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* të ZPS-së për qasje në regjistrat e vizitave, regjistrat e korrespondencës, korrespondencën e bllokuar, nëse ka; regjistrat e telekomunikimeve dhe bisedat e incizuara digjitalisht të Parashtruesit në objektin e paraburgimit të DHS-së nga janari

---

<sup>11</sup> Aktakuza fillestare kundër Parashtruesit dhe tre të akuzuarve të tjerë u konfirmua me vendimin KSC-BC-2020-06, F00026/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, 30 nëntor 2020, publik (origjinali u dorëzua më 26 tetor 2020), para. 15, 231, 349, 360, 417, 436, 444, 521(a). Në vijim, pas vendimeve të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e korrigjuar, të ndryshuar, dhe të ndryshuar më tej, si edhe një version të saj me më pak redaktime, që është aktakuza në fuqi në këtë çështje gjyqësore: shih KSC-BC-2020-06, F000455/A01/RED, Shtojca 1 e Versionit të Redaktuar Publik të Parashtrimin të Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesës për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b), KSC-BC-2020-06/F00455, 3 shtator 2021, publik, 8 shtator 2021 (origjinali u dorëzua më 3 shtator 2021); F00789/A05, Shtojca 5 e Parashtrimin të Aktakuzës së Ndryshuar dhe Dokumenteve Lidhur me Të, 29 prill 2022, publik; F00999/A03, Shtojca 3 e Parashtrimin të Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar, 30 shtator 2022, publike; F01323/A01, Shtojca 1 e Parashtrimeve të Mëtejshme të Prokurorisë sipas Vendimit F01229, 27 shkurt 2023, publik.

<sup>12</sup> KSC-BC-2020-06, F00027/A01/RED, Version i Redaktuar Publik i Fletarrestimit për Hashim Thaçin, 5 nëntor 2020, publik (origjinali u dorëzua më 26 tetor 2020); F00027/A02/RED, Version i Redaktuar Publik i Urdhrit për Transferim në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 5 nëntor 2020, publik (origjinali u dorëzua më 26 tetor 2020).

<sup>13</sup> KSC-BC-2020-06, F00051, Njoftim i Arrestimit të Hashim Thaçit sipas Rregullës 55(4), 5 nëntor 2020, publik; F00053, Njoftim i Pranimit të Hashim Thaçit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe mbi Emërimin e Mbrojtësit, 5 nëntor 2020, publik.

<sup>14</sup> KSC-BC-2020-06, Transkripti i deklaratave hyrëse, 3 prill 2023, f. 2140, publik.

<sup>15</sup> Shih më lart, para. 7.

2023 deri më 30 prill 2023.<sup>16</sup> Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Vetëm konstatoi ndër të tjera, ekzistencën e dyshimit të bazuar se Parashtruesi “kishte kryer, ishte duke kryer, ose ishte në prag të kryerjes së veprave penale sipas nenit 15(2) të Ligjit nga objekti i paraburgimit të DHS-së” në lidhje me procesin aktual në Çështjen 06.<sup>17</sup>

12. Gjatë vitit 2023, Gjykatësi i Vetëm miratoi kërkesa të tjera rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* të ZPS-së, duke autorizuar, ndër të tjera, qasje të mëtejshme në dokumentacionin e qendrës së paraburgimit të DHS-së lidhur me Parashtruesin ose monitorimin e fshehtë të vizitave dhe të thirrjeve telefonike jo të privileguara të tij në objektin e paraburgimit të DHS-së, si dhe zgjatjen e afatit të këtyre masave.<sup>18</sup>

#### D. CAKTIMI I GJYKATËSIT TË PROCEDURËS PARAPRAKE DHE PARASHTRIMI I AKTAKUZËS

13. Më 13 dhjetor 2023, në vijim të njoftimit të ZPS-së sipas rregullës 86(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”) dhe kërkesës në lidhje me të, Kryetarja, në përputhje me nenin 33(1)(a)

<sup>16</sup> KSC-BC-2018-01, F000324/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesat e Prokurorisë për Informacion nga Qendra e Paraburgimit dhe [REDAKTUAR], 5 nëntor 2025, publik (origjinali u dorëzua më 31 mars 2023) (“Vendimi për Autorizim të Qasjes në Informacion nga Objekti i Paraburgimit të DHS-së”), para. 5, 25, 29, 38(a)(d).

<sup>17</sup> Vendim për Autorizim të Qasjes në Informacion nga Objekti i Paraburgimit të DHS-së, para. 19.

<sup>18</sup> KSC-BC-2018-01, F00330/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesat Plotësuese Urgjente të Prokurorisë në lidhje me F00318 dhe F00321, 5 nëntor 2025, publik (origjinali u dorëzua më 14 prill 2023), me Shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale; F00346/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit për Autorizimin e Instalimit të Pajisjeve Përgjuese në Objektin e Paraburgimit, 31 tetor 2025, publik (origjinali u dorëzua më 2 maj 2023), me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale; F00350/COR/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorisë për Masa Hetimore të Posaçme, 3 nëntor 2025, publik (origjinali u dorëzua më 4 maj 2023), me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale; F00363/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorisë për Vazhdimin e Masës Hetimore të Posaçme të Autorizuar në Vendimin F00330, 5 nëntor 2025, publik (origjinali u dorëzua më 1 qershor 2023); F00365/COR/RED, Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Vendimit mbi Kërkesën Plotësuese të Prokurorisë në lidhje me Parashtrimet e Prokurorisë F00340 dhe F00344, 3 nëntor 2025, publik (origjinali u dorëzua më 2 qershor 2023), me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale; F00384/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje të Afateve të Përcaktuara në Vendimet F00350 dhe F00363, 5 nëntor 2025, publik (origjinali u dorëzua më 30 qershor 2023), me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale; F00443/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatjen e Masave të Autorizuara në Vendimin F00384 dhe Qasje në të Dhënat Telefonike, 10 nëntor 2025, publik (origjinali u dorëzua më 30 gusht 2023), me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale; F00518/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë, 5 nëntor 2025, publik (origjinali u dorëzua më 21 nëntor 2023).

të Ligjit, caktoi gjykatësin Giju si Gjykatës të Procedurës Paraprake pas parashtrimit të Aktakuzës në Çështjen 12.<sup>19</sup>

14. Më 15 dhjetor 2023, ZPS-ja dorëzoi një aktakuzë kundër Parashtruesit dhe tre të dyshuarve të tjerë para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.<sup>20</sup>

15. Më 11 mars 2024, në bazë të urdhrimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,<sup>21</sup> ZPS-ja i dorëzoi Gjykatësit të Procedurës Paraprake një aktakuzë të rishikuar.<sup>22</sup>

16. Më 2 maj 2024, ZPS-ja i paraqiti kërkesë Gjykatësit të Procedurës Paraprake për leje për të paraqitur material shtesë në mbështetje të akuzave në Aktakuzën e Rishikuar, dhe pezullimin e vlerësimit të Aktakuzës së Rishikuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake deri në dorëzimin e materialit në fjalë dhe parashtrimin e një aktakuze të ndryshuar.<sup>23</sup>

17. Pas dorëzimit të aktakuzës, gjykatësi Giju, në cilësinë e Gjykatësit të Vetëm të caktuar nga Kryetarja në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit,<sup>24</sup> miratoi kërkesa të tjera rreptësisht konfidenciale *ex parte* të ZPS-së duke autorizuar, ndër të tjera, krijimin e kopjes forenzike dhe ruajtjen e përmbajtjes së të gjithë kompjuterave, si edhe dokumenteve/dosjeve në sistemin e shkëmbimit të mbrojtur elektronik të të dhënave të përdorura nga Parashtruesi në objektin e paraburgimit të DHS-së.<sup>25</sup>

---

<sup>19</sup> KSC-BC-2023-12, F00001, Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, 13 dhjetor 2023, para. 1, publik, Pjesa vendimore.

<sup>20</sup> KSC-BC-2023-12, F00002/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesës Lidhur me Të, konfidenciale, 15 dhjetor 2023.

<sup>21</sup> KSC-BC-2023-12, F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Urdhrit Prokurores së Specializuar sipas rregullës 86(4) të Rregullores, 14 mars 2025, publik (origjinali u dorëzua më 22 shkurt 2024).

<sup>22</sup> KSC-BC-2023-12, F00007/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Rishikuar për Konfirmim, konfidenciale, 11 mars 2024.

<sup>23</sup> KSC-BC-2023-12, F00014, Parashtrime të Prokurorisë sipas Urdhrit F00011, publik, 2 maj 2024. Shih gjithashtu, KSC-BC-2023-12, F00010, Njoftim i Prokurorisë, publik, 19 prill 2024; F00011, Urdhër për Parashtrime, publik, 24 prill 2024; F00012, Kërkesë për Zgjatje të Afatit, publike, 1 maj 2024; F00013, Vendim mbi Zgjatjen e Afatit, publik, 1 maj 2024.

<sup>24</sup> Shih më lart, para. 7.

<sup>25</sup> KSC-BC-2018-01, F00543/RED, Version i Redaktuar Publik i Urdhrit mbi Kërkesën e Prokurorisë për Urdhra për Ruajtjen e Provave, publik, 5 nëntor 2025 (origjinali u dorëzua më 22 dhjetor 2023). Shih gjithashtu KSC-BC-2018-01, F00585/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për

#### E. CAKTIMET E REJA GJYQËSORE

18. Më 6 qershor 2024, pas dorëheqjes së gjykatësit Giju nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë, Kryetarja caktoi më të njëjtën ditë gjykatësen Marzhori Masëlo (“gjykatësja Masëlo”) si Gjykatëse të Vetme për të zëvendësuar gjykatësin Giju në lidhje me dosjen e hetimit.<sup>26</sup> Më të njëjtën ditë, gjykatësja Masëlo u caktua si Gjykatëse e Procedurës Paraprake në Çështjen 12.<sup>27</sup>

#### F. SHQYRTIMI DHE RISHIKIMI I MËTEJSHËM I AKTAKUZËS

19. Më 20 qershor 2024, gjykatësja Masëlo, në cilësinë e Gjykatëses së Procedurës Paraprake e caktuar nga Kryetarja në Çështjen 12, hodhi poshtë kërkesën e ZPS-së për leje për të paraqitur material shtesë në mbështetje të Aktakuzës së Rishikuar dhe për pezullimin e vlerësimit të saj nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake deri në dorëzimin e materialit në fjalë dhe parashtrimin e aktakuzës së ndryshuar.<sup>28</sup>

20. Më 27 qershor 2024, ZPS-ja i paraqiti Gjykatëses së Procedurës Paraprake Aktakuzën e Ndryshuar kundër Parashtruesit dhe katër të dyshuarve të tjerë.<sup>29</sup>

21. Më 12 nëntor 2024, në vijim të urdhrorit të Gjykatëses së Procedurës Paraprake,<sup>30</sup> ZPS-ja parashtrroi Aktakuzën e Ndryshuar më Tej.<sup>31</sup>

#### G. KONFIRMIMI I AKTAKUZËS

22. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi Aktakuzën e

---

Ndryshim të Urdhrave për Ruajtjen e Provave, publik, 16 dhjetor 2025 (origjinali u dorëzua më 19 shkurt 2024).

<sup>26</sup> KSC-BC-2018-01, F00697/COR, Version i Korrigjuar i Vendimit për Caktimin e Gjykatëses së Vetme, publik, 12 korrik 2024 (origjinali u dorëzua më 6 qershor 2024), para. 3-4 dhe Vendimi.

<sup>27</sup> KSC-BC-2023-12, F00015, Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake, publik, 6 qershor 2024.

<sup>28</sup> KSC-BC-2023-12, F00016, Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë për Leje për të Paraqitur Material Shtesë dhe për Pezullimin e Shqyrtimit të Aktakuzës, publik, 20 qershor 2024.

<sup>29</sup> KSC-BC-2023-12, F00017/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar, konfidenciale, 28 qershor 2024.

<sup>30</sup> KSC-BC-2023-12, F00025/RED, Version i Redaktuar Publik i Urdhrit sipas Rregullës 86(4)(b) të Rregullores në lidhje me Pikat 2 dhe 19 të Aktakuzës së Ndryshuar, publik, 14 mars 2025 (origjinali u dorëzua më 6 nëntor 2024).

<sup>31</sup> KSC-BC-2023-12, F00028/A01, Shtojca 1 e Parashtrimit të Aktakuzës së Ndryshuar më Tej për Konfirmim, konfidenciale, 12 nëntor 2024.

Ndryshuar më Tej të ZPS-së kundër Parashtruesit, ku ai dhe katër të akuzuar të tjerë akuzohen për vepra penale sipas nenit 15(2) të Ligjit, konkretisht, vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike, dhe vepra penale kundër rendit publik.<sup>32</sup> Në veçanti, kundër Parashtruesit u ngritën tri akuza për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, sipas neneve 401(2)-(3) dhe (5) të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074 ("KPK"), tri akuza për shkelje e fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të mbrojtur sipas nenit 392(1) të KPK-së dhe një akuzë për shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit të personave të mbrojtur sipas nenit 392(2) të KPK-së, si edhe katër akuza për mosbindje ndaj Gjykatës sipas nenit 393 të KPK-së.<sup>33</sup>

23. Sipas Aktakuzës së Konfirmuar, midis së paku 12 prillit 2023 dhe 2 nëntorit 2023, gjatë vizitave të veçanta jo të privileguara në objektin e paraburgimit të DHS-së dhe me synimin për të ndërhyrë në procesin aktual në Çështjen 06, Parashtruesi u dha të akuzuarve të tjerë në Çështjen 12 informacion konfidencial lidhur me dëshmitarë të ZPS-së dhe bashkërendoi me ta për mënyrën se si të ndikonin në dëshmitë e dëshmitarëve të ZPS-së dhe/ose t'i kontaktonin ata.<sup>34</sup>

24. Pas konfirmimit të Aktakuzës, gjykatësja Masëlo, në cilësinë e Gjykatëses së Vetme e caktuar nga Kryetarja sipas nenit 33(2) të Ligjit,<sup>35</sup> miratoi kërkesa të tjera të ZPS-së duke autorizuar, ndër të tjera, ruajtjen e incizimeve të thirrjeve telefonike të paprivileguara në objektin e paraburgimit të DHS-së që lidhen me Parashtruesin dhe z. Kadri Veseli, një nga të akuzuarit e tjerë në Çështjen 06.<sup>36</sup> Ndonëse Parashtruesi dhe

---

<sup>32</sup> KSC-BC-2023-12, F00036/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, publik, 12 shkurt 2025 (origjinali u dorëzua më 29 nëntor 2024) ("Vendimi i Konfirmimit në Çështjen 12") para. 313(a)-(e).

<sup>33</sup> Vendimi i Konfirmimit në Çështjen 12, para. 313(a).

<sup>34</sup> KSC-BC-2023-12, F00055/A01, Shtojca 1 e Parashtrimi të Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar, publik, 6 dhjetor 2024, para. 7, 9-22, 26.

<sup>35</sup> Shih më lart, para. 18.

<sup>36</sup> Shih, për shembull, KSC-BC-2018-01, F00813/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën e Prokurorisë për Urdhër për Ruajtje të Materialit, publik, 11 nëntor 2025 (origjinali u dorëzua më 24 janar 2025) ("Vendimi mbi Kërkesën për Ruajtje").

personi tjetër në fjalë i morën dhe patën qasje në to, Parashtruesi nuk iu përgjigj atyre.<sup>37</sup> Më të njëjtën ditë, më 24 janar 2025, Gjykatësja e Vetme vendosi që për një kërkesë tjetër të ZPS-së që kishte të bënte vetëm me veprat penale për të cilat Parashtruesi ndiqet penalisht në Çështjen 12 vendimi duhej të merrej nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në atë çështje.<sup>38</sup> Rrjedhimisht, më 27 janar 2025, Gjykatësja e Vetme urdhëroi që kërkesa dhe të gjitha parashtrimet përkatëse në lidhje me hetimet, të kaloheshin nga dosja hetimore në dosjen e Çështjes 12.<sup>39</sup>

25. Më 14 prill 2025, pas apelit të ndërmjetëm të paraqitur nga ZPS-ja me autorizim të Gjykatësës së Procedurës Paraprake<sup>40</sup> dhe vendimit të panelit të Gjykatës së Apelit për t'ia kthyer çështjen Gjykatësës së Procedurës Paraprake,<sup>41</sup> gjykatësja Masëlo ndryshoi Vendimin e Konfirmimit.<sup>42</sup> Konkretisht, ajo konfirmoi një formë shtesë të përgjegjësisë penale sipas nenit 32(3) të KPK-së për Parashtruesin, në lidhje me akuzat për pengim të procesit sipas neneve 401(2)-(3) dhe (5) të KPK-së.<sup>43</sup> Gjithashtu, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi ZPS-në të dorëzonte një aktakuzë të konfirmuar të ndryshuar dhe caktoi datën për dorëzimin e mocioneve paraprake në këtë çështje.<sup>44</sup>

26. Më 16 prill 2025, ZPS-ja dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar të Ndryshuar, që është

<sup>37</sup> Vendimi mbi Kërkesën për Ruajtje, para. 4.

<sup>38</sup> KSC-BC-2018-01, F00812, Vendim mbi Kompetencën e Gjykatësës së Vetme për të Vendosur në lidhje me Kërkesën e ZPS-së F00739, publik, 24 janar 2025.

<sup>39</sup> KSC-BC-2018-01, F00814, Urdhër për Transferimin e Dokumenteve, publik, 27 janar 2024.

<sup>40</sup> KSC-BC-2023-12, F00071, Kërkesë e Prokurorisë për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës (F00036), publik, 9 dhjetor 2024, me Shtojcën 1, publike; F00149, Vendim mbi Kërkesën e Prokurores së Specializuar për Leje për Apelimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, publike, 31 janar 2025.

<sup>41</sup> KSC-BC-2023-12, IA002/F00012/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës, publik, 3 prill 2025 (originali u dorëzua më të njëjtën ditë), para. 80-89, 90.

<sup>42</sup> KSC-BC-2023-12, F00260, Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake, publik, 14 prill 2025 ("Vendimi për Ndryshimin e Vendimit të Konfirmimit të Aktakuzës në Çështjen 12").

<sup>43</sup> Vendim për Ndryshimin e Vendimit të Konfirmimit të Aktakuzës në Çështjen 12, para. 13-23, 31(a).

<sup>44</sup> Vendim për Ndryshimin e Vendimit të Konfirmimit të Aktakuzës në Çështjen 12, para. 24, 30, 31(b), (h).

Aktakuza në fuqi në Çështjen 12.<sup>45</sup>

#### H. MOCIONET PARAPRAKE DHE PROCEDURA E APELIT TË NDËRMJETËM

27. Më 8 maj 2025, Parashtruesi dorëzoi një mocion paraprak në të cilin argumenton ndër të tjera se, kur caktoi Gjykatësen e Vetme sipas nenit 33(2) të Ligjit për shqyrtimin e kërkesave për autorizim gjyqësor dhe aspekte të lidhura me to, të parashtruara nga ZPS-ja përpara dorëzimit të Aktakuzës, Kryetarja në fakt krijoi “një rol gjyqësor të përhershëm”, në kundërshtim me dispozitat e nenit 33(2) të Ligjit i cili përcakton se ky caktim “është i përkohshëm”.<sup>46</sup> Gjithashtu, sipas Parashtruesit, caktimi i mëpasshëm i së njëjtës gjykatëse si Gjykatëse e Procedurës Paraprake në procesin kundër tij në Çështjen 12 shkeli nenin 33(1)(a) dhe (4) të Ligjit, i cili përcakton se, gjykatësi i procedurës paraprake caktohet vetëm “pas dorëzimit të aktakuzës”, dhe se, “kur është caktuar gjykatës i procedurës paraprake ose në një panel për një çështje, një gjykatës nuk mund të jetë anëtar i ndonjë paneli tjetër në një fazë tjetër të së njëjtës çështje”.<sup>47</sup> Në lidhje me këtë, ai parashtron gjithashtu se paanshmëria e Gjykatësës së Procedurës Paraprake mund të jetë cenuar për shkak të dijenisë së saj për parashtrimeve me gjasë dëmtuese në dosjen e hetimit, që nuk janë pjesë e dokumentacionit të Çështjes 12 dhe në të cilat Parashtruesi nuk ka qasje.<sup>48</sup>

28. Më 19 qershor 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi vendim mbi mocionin paraprak të Parashtruesit, duke e hedhur poshtë në tërësi.<sup>49</sup> Që në fillim, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se mocioni paraprak i Parashtruesit nuk kundërshtonte juridiksionin e Dhomave të Specializuara, por kompetencën e saj për të gjykuar çështjen dhe, rrjedhimisht vendosi që nuk do të bënte vlerësimin e tij në

---

<sup>45</sup> KSC-BC-2023-12, F00264, Shtojca 2 e Parashtrimin të Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar, publike, 16 prill 2024.

<sup>46</sup> KSC-BC-2023-12, F00290/RED, Version i Redaktuar Publik i Mocionit Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin, publik, 12 maj 2025 (origjinali u dorëzua më 8 maj 2025) (“Mocioni Paraprak i Parashtruesit”), para. 65-69, me Shtojcën 1, publike.

<sup>47</sup> Mocioni Paraprak i Parashtruesit, para. 70-76, 86.

<sup>48</sup> Mocioni Paraprak i Parashtruesit, para. 77-81.

<sup>49</sup> KSC-BC-2023-12, F00343, Vendim mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin, publik, 19 qershor 2025 (“Vendimi mbi Mocionin Paraprak të Parashtruesit”), para. 42(a).

kuadër të rregullës 97(1)(a) të Rregullores.<sup>50</sup> Megjithatë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake shqyrtoi mocionin e Parashtruesit në bazë të kompetencës së saj sipas nenit 39(1) të Ligjit.<sup>51</sup> Më konkretisht, lidhur me pikat e ngritura nga Parashtruesi lidhur me nenet 33(1)(a), (2), dhe (4) të Ligjit, ajo konkludoi se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka kompetencë të shprehet për këto aspekte, pasi caktimi i gjykatësve të DHS-së është vetëm kompetencë dhe përgjegjësi e Kryetares.<sup>52</sup> Në lidhje me këtë, ajo konstatoi gjithashtu se pretendimi i Parashtruesit se caktimi i së njëjtës gjykatëse si Gjykatëse e Vetme dhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake ishte i palejueshëm përfshihet në fushëveprimin e i rregullës 20 të Rregullores mbi vetëtërheqjen ose përjashtimin e gjykatësve, dhe se Parashtruesi mund dhe duhej ta kishte ngritur këtë aspekt sipas procedurës së përcaktuar në nenin 20(3) të Rregullores.<sup>53</sup>

29. Më 30 qershor 2025, Parashtruesi paraqiti kërkesë për leje për apelim të vendimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake<sup>54</sup> dhe, më 2 korrik 2025, i paraqiti apel të ndërmjetëm të drejtpërdrejtë Panelit të Gjykatës së Apelit.<sup>55</sup>

30. Më 4 gusht 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi vendim me të cilin hodhi poshtë apelin e ndërmjetëm të drejtpërdrejtë të Parashtruesit si të papranueshëm në bazë të nenit 45(2) të Ligjit, për arsye se aspektet e ngritura në të nuk lidheshin, *stricto sensu*, me juridiksionin personal, territorial, kohor, apo lëndor të DHS-së.<sup>56</sup>

31. Më 23 korrik 2025, Gjykatësja e Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e Parashtruesit për leje për apelin e vendimit të saj në lidhje me tri pika, ndër të cilat

<sup>50</sup> Vendim mbi Mocionin Paraprak të Parashtruesit, para. 22.

<sup>51</sup> Vendim mbi Mocionin Paraprak të Parashtruesit, para. 23.

<sup>52</sup> Vendim mbi Mocionin Paraprak të Parashtruesit, para. 38.

<sup>53</sup> Vendim mbi Mocionin Paraprak të Parashtruesit, para. 39.

<sup>54</sup> KSC-BC-2023-12, F00355/RED, Version i Redaktuar Publik i Kërkesës së Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin, publik, 4 korrik 2025 (origjinali u dorëzua më 30 qershor 2025), me Shtojcën 1, publike.

<sup>55</sup> KSC-BC-2023-12, IA0005/F00001/RED/COR, Version i Korrigjuar i Versionit të Redaktuar Publik të Apelit kundër Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin, publik, 7 korrik 2025 (origjinali u dorëzua më 2 korrik 2025), me Shtojcat 1-3, publike.

<sup>56</sup> KSC-BC-2023-12, IA0005/F00005, Vendim mbi Pranueshmërinë e Apelit KSC-BC-2023-12/IA005/F00001, 4 gusht 2025, para. 15-25, 28.

aspektet nëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake kishte bërë gabim ligjor kur (i) vlerësoi se nuk mund të bënte vlerësim të ligjshmërisë së caktimit të saj nga Kryetarja si Gjykatëse e Procedurës Paraprake, dhe (ii) konstatoi se rregulla 20 e Rregullores ia ndalon Parashtruesit të kundërshtojë, përmes një mocioni paraprak, praktikën e caktimit të të njëjtit gjykatës si gjykatës i vetëm dhe gjykatës i procedurës paraprake.<sup>57</sup>

32. Më 18 gusht 2025, Parashtruesi i paraqiti apel të ndërmjetëm Panelit të Gjykatës së Apelit ku argumentonte, ndër të tjera, se caktimi i gjykatës Masëlo si Gjykatëse e Vetme dhe si Gjykatëse e Procedurës Paraprake në Çështjen 12 ishte në shkelje të nenit 33 të Ligjit.<sup>58</sup>

33. Më 28 tetor 2025, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi një vendim me të cilin hodhi poshtë në tërësi apelin e ndërmjetëm.<sup>59</sup> Fillimisht, Paneli i Apelit konstatoi se argumentet e Parashtruesit që caktimi i gjykatës Masëlo si Gjykatëse e Vetme dhe Gjykatëse e Procedurës Paraprake ishte në shkelje të nenit 33 të Ligjit nuk përfshihet në kuadrin e pikave të lejuara për apel dhe i hodhi poshtë ato formalisht.<sup>60</sup> Sa u përket pikave të autorizuar për apel, Paneli i Apelit konstatoi se, ndër të tjera, sipas nenit 33 të Ligjit caktimi i gjykatësve të DHS-së është vetëm kompetencë e Kryetares dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka kompetencë të vlerësojë vendimet e Kryetares për këtë aspekt.<sup>61</sup> Sipas Panelit të Apelit, rregulla 20 e Rregullores është forumi i duhur brenda kornizës së DHS-së për të kundërshtuar caktimin e një

<sup>57</sup> KSC-BC-2023-12, F00391, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin, publik, 23 korrik 2025, para. 6(c)-(d), 31-34, 35(b).

<sup>58</sup> KSC-BC-2023-12, IA0007/F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Apelit të Mbrojtjes së Thaçit kundër Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin, publik, 20 gusht 2025 (origjinali u dorëzua më 18 gusht 2025), para. 24-30, 49, 54. Shih gjithashtu KSC-BC-2023-12, IA0007/F00006, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë ndaj Apelit kundër Vendimit mbi Mocionet Paraprake në lidhje me Juridiksionin, publike, 3 shtator 2025, para. 19, me Shtojcën 1, publike.

<sup>59</sup> KSC-BC-2023-12, IA0007/F00007, Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionin Paraprak të Mbrojtjes së Thaçit në lidhje me Juridiksionin dhe Vendimit mbi Mocionin Paraprak për Shtyrje dhe Veçim të Procesit, publik, 28 tetor 2025 (“Vendimi mbi Apelin e Parashtruesit lidhur me Mocionet Paraprake”), para. 49, 79-80.

<sup>60</sup> Vendimi mbi Apelin e Parashtruesit lidhur me Mocionet Paraprake, para. 64.

<sup>61</sup> Vendimi mbi Apelin e Parashtruesit lidhur me Mocionet Paraprake, para 65-69.

gjykatësi nga Kryetarja.<sup>62</sup> Në këtë aspekt, Paneli konstatoi gjithashtu se në tekstin e rregullës 20 të Rregullores jepet një listë e gjerë dhe joshteruese e arsyeve për të cilat një palë mund të kërkojë përjashtimin e një gjykatësi të DHS-së dhe se, për këtë arsye, argumenti i Parashtruesit lidhur me palejueshmërinë e caktimit të të njëjtit gjykatës si gjykatës i vetëm dhe si gjykatës i procedurës paraprake përfshihet në fushëveprimin e këtij neni.<sup>63</sup> Rrjedhimisht, sipas mendimit të Panelit të Apelit, Parashtruesi mund të kishte përdorur procedurën sipas nenit 20(3) të Rregullores që ofron forumin për të kundërshtuar vendimet e caktimit nga Kryetarja.<sup>64</sup>

#### I. KALIMI PËR GJYKIM I ÇËSHTJES NË LIDHJE ME ADMINISTRIMIN E DREJTËSISË

34. Më 3 nëntor 2025, Parashtruesi dorëzoi njoftim me anë të cilit informoi Gjykatësen e Procedurës Paraprake për synimin për t'i paraqitur Dhomës kërkesë referuese sipas nenit 49(3) të Ligjit lidhur me disa shkelje të të drejtave kushtetuese të tij që nuk u korrigjuan nga paneli i Gjykatës së Apelit, duke vënë në dukje gjithashtu se rregulla 98(1) e Rregullores përcakton se duhet “një vendim *i formës së prerë* mbi mocionet paraprake përpara se dosja e çështjes t'i kalohet Trupit Gjykues”.<sup>65</sup>

35. Më 11 nëntor 2025, në përputhje me rregullën 98(3) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake njoftoi Kryetaren se Çështja 12 do të ishte gati për t'iu kaluar trupit gjykues më 12 nëntor 2025.<sup>66</sup>

36. Më 12 nëntor 2025, duke pasur parasysh nenin 25(2) të Ligjit, dhe se akuzat kundër Parashtruesit dhe katër të akuzuarve të tjerë në Çështjen 12 nuk klasifikohen si krime të rënda sipas nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Kodi nr. 08/L-032, Kryetarja vendosi të caktojë gjykatësin Kristofer Gosnell si Gjykatës të

<sup>62</sup> Vendimi mbi Apelin e Parashtruesit lidhur me Mocionet Paraprake, para. 70.

<sup>63</sup> Vendimi mbi Apelin e Parashtruesit lidhur me Mocionet Paraprake, para. 71-73.

<sup>64</sup> Vendimi mbi Apelin e Parashtruesit lidhur me Mocionet Paraprake, para. 74-75.

<sup>65</sup> KSC-BC-2023-12, F00535, Njoftim i Mbrojtjes së Thaçit për Synimin për të Paraqitur Kërkesë Referuese sipas Nenit 49, publik, 3 nëntor 2025, para. 1, 3-4 (theksimi i shtuar).

<sup>66</sup> KSC-BC-2023-12, F00541, Njoftim sipas Rregullës 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, publik, 11 nëntor 2025.

Vetëm i ngarkuar me gjykimin e çështjes, pas kalimit të dosjes së çështjes gjyqësore.<sup>67</sup> Më të njëjtën ditë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, pasi konstatoi se vendimi i Panelit të Apelit mbi mocionet paraprake të Parashtruesit ishte i formës së prerë sipas rregullës 98(1) të Rregullores, dhe se dosja e çështjes ishte e plotë, ia kaloi çështjen 12 Gjykatësit të Vetëm të ngarkuar me gjykimin e Çështjes 12 në përputhje me rregullën 98 të Rregullores.<sup>68</sup>

37. Gjykimi në Çështjen 12 është planifikuar të fillojë më 27 shkurt 2026.<sup>69</sup>

### III. SHKELJET E PRETENDUARA

38. Ankesa që Parashtruesi i paraqet Dhomës është se, duke caktuar Gjykatësen e Vetme për të vlerësuar kërkesat për autorizim gjyqësor dhe çështje të lidhura me to, të parashtruara nga ZPS-ja përpara dorëzimit të aktakuzës, Kryetarja në fakt krijoi “një rol gjyqësor të përhershëm”, në kundërshtim me dispozitat e nenit 33(2) të Ligjit sipas të cilave ky caktim duhet të jetë “i përkohshëm”.<sup>70</sup> Ai u ankua gjithashtu se caktimi i mëpasshëm i së njëjtës gjykatëse si Gjykatëse e Procedurës Paraprake në procesin kundër tij në Çështjen 12 ishte në shkelje të nenit 33(1)(a) të Ligjit, sipas së cilit gjykatësi i procedurës paraprake caktohet vetëm “pas dorëzimit të Aktakuzës”, dhe nenit 33(4) të Ligjit i cili përcakton se, “kur caktohet gjykatës i procedurës paraprake apo anëtar i ndonjë paneli për një çështje, ai gjykatës nuk mund të jetë anëtar i një paneli tjetër në një fazë tjetër të së njëjtës çështje”.<sup>71</sup> Parashtruesi parashtron se shkeljet e nenit 33(1)(a), (2), dhe (4) të Ligjit nga Kryetarja, të kombinuara me moskorrigjimin e mëpasshëm të tyre nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake dhe nga Paneli i Apelit,<sup>72</sup>

---

<sup>67</sup> KSC-BC-2023-12, F00543, Vendim për Caktimin e një Gjykatësit të Vetëm për Gjykimin e Çështjes, publik, 12 nëntor 2025, para. 4, Vendimi.

<sup>68</sup> KSC-BC-2023-12, F00544, Vendim mbi Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Gjykatësit të Vetëm, publik, 12 nëntor 2025, para. 24-26, 28, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcën 2, publike.

<sup>69</sup> KSC-BC-2023-12, F00705, Vendim mbi Kërkesën për Shtyrje të Fillimit të Procesit të Gjyimit, publik, 29 janar 2026, para. 8, 9(b).

<sup>70</sup> Kërkesa Referuese, para. 33-42.

<sup>71</sup> Kërkesa Referuese, para. 43-51.

<sup>72</sup> Kërkesa Referuese, para. 52-77.

përbëjnë shkelje të së drejtës së tij që për akuzat penale kundër tij të vendosë një “gjykatë e themeluar me ligj” në përputhje me nenin 31(2) të Kushtetutës dhe nenin 6(1) të Konventës.<sup>73</sup>

39. Parashtruesi u ankua gjithashtu se masat hetimore të posaçme dhe masa të tjera të autorizuar në lidhje me të nuk u vendosën “në përputhje me ligjin”, pasi Gjykatësja e Vetme në dosjen e hetimit dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake në Çështjen 12 ishin caktuar në shkelje të nenit 33 të Ligjit.<sup>74</sup> Sipas Parashtruesit, kjo ishte shkelje e të drejtës së tij për respektim të jetës private dhe familjare sipas nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të Konventës.<sup>75</sup>

#### IV. JURIDIKSIONI

40. Dhoma vëren se Parashtruesi dorëzoi Kërkesën Referuese sipas nenit 113(7) të Kushtetutës dhe paraqiti ankesa në lidhje me proceset aktuale kundër tij para DHS-së. Rrjedhimisht, Kërkesa Referuese lidhet me DHS-në dhe ZPS-në, sikurse kërkohet nga neni 162(3) i Kushtetutës dhe nenet 3(1) dhe 49(2) të Ligjit. Rrjedhimisht, Dhoma ka juridiksion për të vendosur lidhur me Kërkesën Referuese.

#### V. KUADRI I SHQYRTIMIT

41. Fillimisht, Dhoma rikujton rolin e vet për mbikëqyrjen e punës së DHS-së dhe ZPS-së në lidhje me të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.<sup>76</sup> Në

<sup>73</sup> Kërkesa Referuese, para. 3, 29-32, 78.

<sup>74</sup> Kërkesa Referuese, para. 3, 79-84.

<sup>75</sup> Kërkesa Referuese, para. 3, 84.

<sup>76</sup> KSC-CC-2025-09, F00007, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Salih Mustafës në lidhje me të Drejtat Themelore të Garantuara nga Neni 33(3) i Kushtetutës së Kosovës, publik, 9 korrik 2025, (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Proporcionalitetin e Ndëshkimit”), para. 33; KSC-CC-2024-27, F00011, Aktvendim mbi Kërkesën Referuese të Salih Mustafës në lidhje me të Drejtat Themelore të Garantuara nga Nenet 31 dhe 33 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, publik, 17 prill 2025 (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Të Drejtat për Gjykim të Drejtë dhe Parimin Lex Mitior”), para. 57; KSC-CC-2024-28, F00003, Aktvendim mbi Kërkesën Referuese të Haxhi Shalës drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 6 mars 2025 (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të Haxhi Shalës në lidhje me Paraburgimin”), para. 28; KSC-CC-2024-25, F00006/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese drejtuar

bazë të nenit 49(1) të Ligjit, Dhoma është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës në lidhje me juridiksionin lëndor dhe punën e DHS-së dhe ZPS-së.

42. Sa u përket të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës, Dhoma vë në dukje se, në bazë të nenit 22(2) të Kushtetutës, garancitë e parashikuara në Konventë zbatohen në nivel kushtetues.<sup>77</sup> Madje, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka theksuar se të drejtat dhe liritë e garantuara nga instrumentet ndërkombëtare të përmendura në nenin 22 të Kushtetutës “kanë statusin e normave të rendit kushtetues dhe janë pjesë integrale e Kushtetutës, në të njëjtën mënyrë si të gjitha dispozitat e tjera të Kushtetutës”.<sup>78</sup> Dhoma rikujton se ankesat e Parashtruesit kanë lidhje me nenet 31(2) dhe 36 të Kushtetutës dhe nenet 6(1) dhe 8 të Konventës dhe se, rrjedhimisht, Kërkesa Referuese duhet të shqyrtohet në bazë të këtyre dispozitave.

43. Në lidhje me vlerësimin e Kërkesës Referuese, Dhoma vë në dukje se, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara në Kushtetutë “interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut [GJEDNJ]”. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e Kosovës vazhdimisht ka njohur zbatueshmërinë e nenit 53 të Kushtetutës në vlerësimet e

---

Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Hashim Thaçi, publik, 24 dhjetor 2024 (origjinali u dorëzua më 15 nëntor 2024) (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Masat Hetimore të Posaçme”), para. 27; KSC-CC-2023-22, F00011, Aktvendim mbi Kërkesën Referuese të Nasim Haradinajt drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik, 31 maj 2024 (“Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt lidhur me Ligjshmërinë, Shtytjen dhe Lirinë e Shprehjes”), para. 65. Shih gjithashtu KSC-CC-2019-05, F00012, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Mahir Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë të 20 Dhjetorit 2018, publik, 20 shkurt 2019 (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të M. Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë”), para. 24.

<sup>77</sup> Shih, për shembull, KSC-CC-2022-13, F00010; KSC-CC-2022-14, F00009, Vendim mbi Kërkesën Referuese të Jakup Krasniqit në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët dhe Kërkesën Referuese të Kadri Veselit në lidhje me Vendimin e Panelit të Apelit për Kundërshtimet ndaj Juridiksionit të Dhomave të Specializuara, publik, 13 qershor 2022 (“Vendimi mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale”), para. 34, me referenca të mëtejshme nga jurisprudenca.

<sup>78</sup> Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve* [A.A.U.ZH. nr. 20/2019 të 30 tetorit 2019; dhe A.A.U.ZH. nr. 21/2019, të 5 nëntorit 2019] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, KI 207/19, Aktgjykim, 10 dhjetor 2020 (5 janar 2021), para. 111.

kërkesave referuese kushtetuese.<sup>79</sup> Ajo gjithashtu është shprehur se “Gjykata Kushtetuese është e obliguar që të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në pajtim me vendimet gjyqësore të [GJEDNJ-së]”.<sup>80</sup> Mbi këtë bazë, dhe duke pasur parasysh nenet 22(2) dhe 53 të Kushtetutës, kjo Dhomë mban parasysh në mënyrë të veçantë jurisprudencën e GJEDNJ-së në shqyrtimin e Kërkesës Referuese të Parashtruesit.<sup>81</sup>

44. Së fundi, Dhoma rikujton se detyra e saj sipas nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(1) dhe (3) të Ligjit, është që të vlerësojë nëse parregullsitë për të cilat ankohet Parashtruesi kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë.<sup>82</sup> Rrjedhimisht, Dhoma nuk vendos për fajësinë apo pafajësinë e Parashtruesit.<sup>83</sup> Po kështu, Dhoma nuk ka për detyrë të vendosë nëse konstatimet e

<sup>79</sup> Shih, për shembull, Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Kërkesë për Vlerësim të Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml nr. 225/2017 të 18 dhjetorit 2017*, KI 37/18, Aktvendim për papranueshmëri, 30 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 37; *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Vendimit Pn II nr. 1/17 të Gjykatës Supreme të Kosovës të 30 Janarit 2017 në lidhje me Vendimin Pml nr. 300/16 të Gjykatës Supreme të 12 dhjetorit 2016*, KI 62/17, Aktgjykim, 29 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 43; *Kërkesë për vlerësim të Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml nr. 225/2017 të 18 dhjetorit 2017*, KI 34/18, Aktvendim për papranueshmëri, 23 maj 2018 (11 qershor 2018), para. 41.

<sup>80</sup> Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës PML nr. 181/15, të 6 nëntorit 2015*, KI 43/16, Aktvendim për Papranueshmëri, 14 prill 2016 (16 maj 2016), para. 50 (theksimi i shtuar).

<sup>81</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Proporcionalitetin e Ndëshkimit*, para. 35 në lidhje me *Të Drejtat për Gjykim të Drejtë dhe Parimin lex mitior*, para. 59; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Shalës në lidhje me Paraburgimin*, para. 30; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit në lidhje me Masat Hetimore të Posaçme*, para. 29; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt lidhur me Ligjshmërinë, Shtytjen dhe Lirinë e Shprehjes*, para. 67; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të M. Hasanit në lidhje me Urdhrin e Prokurorisë*, para. 26.

<sup>82</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Proporcionalitetin e Ndëshkimit*, para. 36; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Të Drejtat për Gjykim të Drejtë dhe Parimin lex mitior*, para. 60; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit në lidhje me Masat Hetimore të Posaçme*, para. 30; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt lidhur me Ligjshmërinë, Shtytjen dhe Lirinë e Shprehjes*, para. 68; KSC-CC-2022-15, F00010, *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Hashim Thaçit në lidhje me të Drejtën për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme të Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsyetuar, publik, 13 qershor 2022 (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit”)*, para. 41. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml nr. 19/2022 të 15 shkurtit 2022*, KI 74/22, Aktgjykim, 7 nëntor 2023 (5 dhjetor 2023), para. 72.

<sup>83</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Proporcionalitetin e Ndëshkimit*, para. 36; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Të Drejtat për Gjykim të Drejtë dhe Parimin lex mitior*, para. 60; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit në lidhje me Masat Hetimore të Posaçme*, para. 30; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt lidhur me Ligjshmërinë, Shtytjen dhe Lirinë e Shprehjes*,

dhomave penale ishin të sakta në aspektin faktik apo ligjor.<sup>84</sup> Përndryshe, ajo do të ndërmerre rolin e dhomës së apelit, që do të ishte mosrespektim i kufijve të kompetencave të saj sipas neneve 113 dhe 162(3) të Kushtetutës.<sup>85</sup>

45. Dhoma mund t'i vërë në pikëpyetje ato konstatime vetëm nëse janë arbitrare në mënyrë aq flagrante dhe të dukshme, saqë shkaktojnë në vetvete shkelje të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.<sup>86</sup> Për shembull, kjo mund të ndodhë, ndër të tjera, në rastin e gabimeve të qarta në vlerësim që nuk do të mund të bëheshin kurrësi nga asnjë gjykatë e arsyeshme,<sup>87</sup> përfundimeve të paarsyeshme për fakte që janë kaq të dukshme dhe të qarta në pamje të parë, saqë i bëjnë konstatimet e një gjykate të duken krejtësisht arbitrare,<sup>88</sup> ose interpretimeve dhe zbatimit qartësisht

---

para. 68; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 41. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml nr. 224/220 të 17 shtatorit 2020*, KI 31/21, Aktvendim për papranueshmëri, 5 maj 2021 (21 maj 2021), para. 35.

<sup>84</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Proporcionalitetin e Ndëshkimit*, para. 36; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Të Drejtat për Gjykim të Drejtë dhe Parimin lex mitior*, para. 60; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit në lidhje me Masat Hetimore të Posaçme*, para. 30; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt lidhur me Ligjshmërinë, Shtytjen dhe Lirinë e Shprehjes*, para. 68; KSC-CC-2020-08, F00020/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese të [REDAKTUAR] në vijim të Vendimit të Gjykatës të Vetëm, publik, 12 qershor 2020 (originali u dorëzua më 22 prill 2020) ("*Vendimi në lidhje me Vendimin e Gjykatës të Vetëm*"), para. 36. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 31/21, përmendur më lart, para. 35-36.

<sup>85</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Proporcionalitetin e Ndëshkimit*, para. 36; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Të Drejtat për Gjykim të Drejtë dhe Parimin lex mitior*, para. 60; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit në lidhje me Masat Hetimore të Posaçme*, para. 30; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt lidhur me Ligjshmërinë, Shtytjen dhe Lirinë e Shprehjes*, para. 68; *Vendim në lidhje me Vendimin e Gjykatës të Vetëm*, para. 36; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml nr. 41/2017 të 3 korrikut 2017*, KI 119/17, Aktvendim për papranueshmëri, 3 prill 2019 (3 maj 2019), para. 87. Shih gjithashtu ECtHR, *Kemmache v. France (no. 3)*, no. 17621/91, 24 November 1994, para. 44.

<sup>86</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Proporcionalitetin e Ndëshkimit*, para. 37; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Të Drejtat për Gjykim të Drejtë dhe Parimin lex mitior*, para. 61; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit në lidhje me Masat Hetimore të Posaçme*, para. 31; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt lidhur me Ligjshmërinë, Shtytjen dhe Lirinë e Shprehjes*, para. 69; *Vendim në lidhje me Vendimin e Gjykatës të Vetëm*, para. 36. Shih gjithashtu ECtHR, *De Tommaso v. Italy* [GC], no. 43395/09, 23 February 2017, para. 170; Kosovë, Gjykata Kushtetuese, KI 37/18, përmendur më lart, para. 41.

<sup>87</sup> ECtHR, *Dulaurans v. France*, no. 34553/97, 21 March 2000, paras 33-39. Shih gjithashtu ECtHR, *Bochan v. Ukraine (no. 2)* [GC], no. 22251/08, 5 February 2015, para. 62.

<sup>88</sup> ECtHR, *Khamidov v. Russia*, no. 72118/08, 15 November 2007, paras 170-175.

të gabuar të ligjit përkatës, ose arsytimit që nuk ka bazë ligjore ose është aq qartësisht i pasaktë saqë mund të konsiderohet si tejet arbitrar ose si mohim i drejtësisë.<sup>89</sup>

## VI. PRANUESHMËRIA

46. Së pari, Dhoma duhet të përcaktojë nëse ankesat e paraqitura nga Parashtruesi në Kërkesën Referuese janë të pranueshme.<sup>90</sup> Kjo rrjedh nga neni 113(1) i Kushtetutës, sipas të cilit Dhoma vendos vetëm për çështje që i paraqiten “në mënyrë të ligjshme nga palë të autorizuar”.<sup>91</sup> Gjithashtu, rregulla 15(1) e Rregullores së DHSGJK-së përcakton se Dhoma vendos mbi “pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e një referimi të bërë në bazë të nenit 49 të Ligjit”. Këto dispozita parashikojnë përgjegjësinë e

<sup>89</sup> ECtHR, *Anđelković v. Serbia*, no. 1401/08, 9 April 2013, paras 24-29; *Bochan v. Ukraine (no. 2)* [GC], cituar më lart, , para. 60-65.

<sup>90</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Proporcionalitetin e Ndëshkimit*, para. 38; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Të Drejtat për Gjykim të Drejtë dhe Parimin lex mitior*, para. 62; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Shalës në lidhje me Paraburgimin*, para. 31; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit në lidhje me Masat Hetimore të Posaçme*, para. 37; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt lidhur me Ligjshmërinë, Shtytjen dhe Lirinë e Shprehjes*, para. 70; KSC-CC-2023-21, F00006, *Vendim mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Shala të Garantuara nga Nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, publik, 29 gusht 2023 (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme”), para. 19; *Vendim mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 36.*

<sup>91</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Proporcionalitetin e Ndëshkimit*, para. 38; *Aktvendim mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Të Drejtat për Gjykim të Drejtë dhe Parimin lex mitior*, para. 62; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Shalës në lidhje me Paraburgimin*, para. 31; *Aktvendim mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt lidhur me Ligjshmërinë, Shtytjen dhe Lirinë e Shprehjes*, para. 70; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 19; KSC-CC-2022-19, F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës në lidhje me të Drejtat Themelore të Garantuara nga Nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës së Kosovës dhe Nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, publik, 15 dhjetor 2022 (“Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me Kërkesën për Heqjen e Prokurorit të Specializuar”), para. 14. Shih gjithashtu Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AE. nr. 287/18 të 27 majit 2019 dhe Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK. nr. 330/2019 të 1 gushtit 2019*, KI 195/19, Aktgjykim, 5 maj 2021 (31 maj 2021), para. 68-69; *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 313/2018, të 10 dhjetorit 2018*, KI 12/19, Aktvendim për papranueshmëri, 10 prill 2019 (3 maj 2019), para. 30-31.

Dhomës për të vlerësuar së pari *ex officio* nëse Kërkesa Referuese është e pranueshme apo jo.<sup>92</sup>

47. Për këtë arsye, Dhoma do të shqyrtojë aspektin e pranueshmërisë duke mbajtur parasysh disa prej kritereve të pranueshmërinë të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj dhe në Rregulloren e DHSGJK-së, që janë relevante për vlerësimin aktual. Duke pasur parasysh se Parashtruesi ka paraqitur dy ankesa të ndryshme në Kërkesën Referuese, pranueshmëria e secilës do të shqyrtohet veçmas.

A. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 31(2) TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 6(1) TË KONVENTËS

### 1. Parashtrimet

48. Parashtruesi argumenton se Kërkesa Referuese është e pranueshme.<sup>93</sup> Ndonëse pranon se në vendimet mbi kërkesa referuese të mëparshme, Dhoma konstatoi se ankesat sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës janë të papranueshme për shkak të mungesës së statusit të viktimës në qoftë se paraqiteshin përpara dhënies së aktgjykimit të formës së prerë, Parashtruesi argumentoi se, megjithatë, mund të argumentonte se është viktimë e shkeljeve të pretenduara sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës edhe në këtë fazë të procesit.<sup>94</sup> Si shembull ai përmendi rastin e shqyrtimit të një kërkesë referuese të mëparshme të tij lidhur me të drejtën e gjyqimit nga një “gjykatë të themeluar me ligj” në kuadër të procesit në Çështjen 06, ku Dhoma kishte vënë në dukje “natyrën themelore” të aspektit të ngritur dhe e kishte vlerësuar “me vend që ta shqyrtonte atë pikë” dhe të vlerësonte nëse dukej se ishte bërë shkelje

<sup>92</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me Proporcionalitetin e Ndëshkimit*, para. 38; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të S. Mustafës në lidhje me të Drejtat për Gjykim të Drejtë dhe Parimin lex mitior*, para. 62; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Shalës në lidhje me Paraburgimin*, para. 31; *Aktvendimi mbi Kërkesën Referuese të N. Haradinajt lidhur me Ligjshmërinë, Shtytjen dhe Lirinë e Shprehjes*, para. 70; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 19; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me Kërkesën për Heqjen e Prokurorit të Specializuar*, para. 14; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 43.

<sup>93</sup> Kërkesa Referuese, para. 24.

<sup>94</sup> Kërkesa Referuese, para. 25-26.

në atë aspekt.<sup>95</sup> Sipas Parashtruesit, aspekti i ngritur në këtë Kërkesë Referuese është po aq themelor, pasi lidhet me vlefshmërinë e caktimit nga Kryetarja të “të gjithë” gjykatësve të DHS-së në fazat e hershme të proceseve, dhe ka gjasë të ndikojë në “të gjitha proceset” dhe jo vetëm atë të Çështjes 12.<sup>96</sup>

49. Gjithashtu, sipas Parashtruesit, shkeljet e nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës që pretendohen në Kërkesë Referuese nuk janë aspekte që mund të korrigjohen në faza të mëvonshme të procesit.<sup>97</sup> Në veçanti, Parashtruesi argumenton se Çështja 12 bazohet në prova që nuk u morën në përputhje me Ligjin, pasi u autorizuan nga gjykatës që nuk u caktuan në mënyrë të rregullt sipas nenit 33 të Ligjit.<sup>98</sup> Parashtruesi pretendon gjithashtu se Aktakuza e Ndryshuar më Tej në Çështjen 12 nuk u paraqit në përputhje me Ligjin dhe argumenton se kjo pavlefshmëri mund të korrigjohet vetëm me një vendim të ri konfirmimi nga një Gjykatës i Procedurës Paraprake i caktuar në mënyrë të rregullt.<sup>99</sup> Sipas Parashtruesit, pritja deri në fund të procesit për të përcaktuar nëse caktimi ishte i drejtë do të shkaktoje padrejtësi të mëtejshme, pasi me gjasë do të çonte në një proces gjyqësor të tretë të gjatë ndaj tij.<sup>100</sup>

50. Së fundi, lidhur me këtë aspekt, Parashtruesi argumenton se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të disponueshme sa i përket shkeljes së pretenduar dhe se Kërkesa Referuese është paraqitur brenda afatit, përkatësisht brenda dy (2) muajsh nga vendimi përfundimtar për aspektet e ngritura, që, sipas, Parashtruesit ishte vendimi i Panelit të Apelit i 28 tetorit 2025, për të cilin ai u njoftua më 29 tetor 2025.<sup>101</sup>

---

<sup>95</sup> Kërkesa Referuese, para. 26(i).

<sup>96</sup> Kërkesa Referuese, para. 26(i).

<sup>97</sup> Kërkesa Referuese, para. 26(ii).

<sup>98</sup> Kërkesa Referuese, para. 26(ii).

<sup>99</sup> Kërkesa Referuese, para. 26(ii).

<sup>100</sup> Kërkesa Referuese, para. 26(ii).

<sup>101</sup> Kërkesa Referuese, para. 27-28.

## 2. Vlerësimi i Dhomës

51. Dhoma rikujton se sipas nenit 113(7) të Kushtetutës dhe nenit 49(3) të Ligjit, individët kanë të drejtë t'i referojnë Dhomës shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara në Kushtetutë. Kjo parashihet edhe në rregullën 20(1) të Rregullores së DHSGJK-së. Dhoma vëren gjithashtu se rregulla 14(f) e Rregullores së DHSGJK-së përcakton se kërkesa referuese është e papranueshme në qoftë se asgjë në të, ose pjesë specifike të saj, nuk krijon përshtypjen e shkeljes së një të drejte kushtetuese.

52. Fillimisht, Dhoma mban parasysh se faza e procedurës paraprake në Çështjen 12 ka përfunduar dhe gjykimi pritet të fillojë më 27 shkurt 2026.<sup>102</sup> Duke qenë se procesi penale kundër Parashtruesit nuk ka përfunduar dhe se ende nuk është marrë vendim në lidhje me akuzat e ngritura, Dhoma duhet të vendosë së pari nëse Parashtruesi mund të argumentojë se është viktimë e shkeljes së pretenduar në këtë fazë të procesit.<sup>103</sup>

53. Dhoma vëren se ankesa e Parashtruesit në lidhje me caktimin e parregullt të gjykatësve sipas nenit 33 të Ligjit ka të bëjë me një aspekt konkret të garancive për gjykim të drejtë të përfshira në nenin 31(2) të Kushtetutës, si edhe në nenin 6(1) të Konventës. Konkretisht, kjo lidhet me të drejtën e Parashtruesit që për akuzat kundër tij të vendosë një "gjykatë e themeluar me ligj".<sup>104</sup> Gjithashtu, duke qenë se ankesa e Parashtruesit mund të interpretohet edhe se, në thelb, ngre çështjen e mungesës së

<sup>102</sup> Shih më lart, para. 36-37.

<sup>103</sup> Shih, ngjashëm, *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 21; *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës lidhur me Kërkesën për Heqjen e Prokurorit të Specializuar*, para. 18; KSC-CC-2022-18, F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën Referuese të Pjetër Shalës drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me të Drejtat Themelore të Garantuara nga Nenet 30 dhe 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 22 gusht 2022 ("*Vendimi mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Qasjen në Material*"), para. 15; *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 54; *Vendimi mbi Kërkesat Referuese të J. Krasniqit dhe K. Veselit në lidhje me Akuzat Penale*, para. 38.

<sup>104</sup> Shih, për shembull, ECtHR, *Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland* [GC], no. 26374/18, 1 December 2020, paras 212-213, me referenca të mëtejshme nga jurisprudenca.

paanshmërisë gjyqësore të Gjykatës së Procedurës Paraprake për shkak të rolit të saj si Gjykatë e Vetme,<sup>105</sup> kjo ka të bëjë me të drejtën që për akuzat kundër tij të vendosë një “gjykatë e paanshme”.<sup>106</sup>

54. Sikurse u theksua më lart, procedura penale kundër Parashtruesit në Çështjen 12 nuk ka përfunduar<sup>107</sup> dhe se akuzat duhet të ekzaminohen dhe të përcaktohen nga Gjykatësi i Vetëm i ngarkuar me gjykimin e çështjes dhe, sipas rastit, Gjykata e Apelit dhe paneli i Gjykatës Supreme, në përputhje me kompetencat e tyre përkatëse. Rrjedhimisht, në këtë fazë të procesit nuk dihet cili do të jetë vendimi lidhur me akuzat kundër Parashtruesit. Sidoqoftë, rezultati i procesit mund të jetë relevant për konstatimin nëse një individ mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të pretenduar të së drejtës për gjykim të drejtë sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës.<sup>108</sup>

55. Në lidhje me këtë, Dhoma thekson se, në përputhje me jurisprudencën e afirmuar të GJEDNJ-së, një individ nuk mund të pretendojë se është viktimë e një shkeljeje të së drejtës së tij ose të saj për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës kur procesi në fjalë është ndërprerë ose individi është shpallur i pafajshëm.<sup>109</sup> Përjashtimet e kufizuara nga kjo rregull kanë të bëjnë, për shembull, me aspekte që lidhen me kohëzgjatjen e arsyeshme të procesit ose qasjen në gjykatë.<sup>110</sup> Rrjedhimisht, në këtë fazë të procesit, Parashtruesi nuk mund të pretendojë se është viktimë e shkeljes së

<sup>105</sup> Kërkesa Referuese, para. 47-50.

<sup>106</sup> Shih, për shembull, ECtHR, *Borg v. Malta*, no. 37537/13, 12 January 2016, paras 81, 83.

<sup>107</sup> Shih më lart, para. 52.

<sup>108</sup> Shih, ngjashëm, *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 21; *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Qasjen në Material*, para. 17; *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 60.

<sup>109</sup> ECtHR, *Sakhnovskiy v. Russia* [GC], no. 21272/03, 2 November 2010, para. 77 (“*Sakhnovskiy v. Russia*”); *Bouglame v. Belgium* (dec.), no. 16147/08, 2 March 2010; *Oleksy v. Poland* (dec.), no. 1379/06, 16 June 2009. Shih gjithashtu *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 26; *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Qasjen në Material*, para. 18; *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 60.

<sup>110</sup> *Sakhnovskiy v. Russia*, para. 77, me referenca të mëtejshme nga jurisprudenca. Shih gjithashtu *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 26.

pretenduar të së drejtës së tij për gjykim të drejtë sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(2) të Konventës. Rrjedhimisht, në këtë fazë, nuk është e nevojshme që Dhoma të vendosë se si do ta zbatonte këtë jurisprudence të GJEDNJ-së.<sup>111</sup>

56. Krahas sa më lart, Dhoma mban parasysh argumentin e Parashtruesit se, në shqyrtimin e një kërkesë referuese të mëparshme të tij, ndër të tjera, në lidhje me të drejtën që për akuzat ndaj tij të vendosë një “gjykatë e themeluar me ligj”, Dhoma “e vlerësoi me vend të trajtojë këtë aspekt të ankesës” mbi bazën se “ishte aspekt themelor që lidhet me funksionimin e DHS-së”.<sup>112</sup> Sidoqoftë, Dhoma theksoi gjithashtu shprehimisht se, “duke pasur parasysh se ankesa është e parakohshme”, ajo duhej të tregonte kujdes të veçantë “në atë fazë [konkrete], që të mos ndërhynte në kompetencat e paneleve të tjerë të DHS-së në nxjerrjen e përfundimeve për pika juridike dhe faktike që lidhen me çështjen penale në shqyrtim prej tyre”,<sup>113</sup> dhe se “ky vlerësim nuk përjashtonte mundësinë e vendimeve të ardhshme mbi ankesa [...] Parashtruesi mund t’i paraqesë Dhomës” në një fazë të mëvonshme të procesit.<sup>114</sup> Rrjedhimisht, ndonëse cekën themelësinë,<sup>115</sup> komentet e Dhomës nuk përbënin vendim lidhur me to dhe nuk nënkuptonin se kërkesa referuese në fjalë ishte e pranueshme. Në këtë rast, Dhoma nuk e vlerëson të nevojshme të shqyrtojë pikën e ngritur nga Parashtruesi në këtë fazë të procesit.<sup>116</sup>

57. Sa i përket pretendimit të Parashtruesit se shkelja e pretenduar e nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës nuk mund të ndreqet më vonë gjatë

---

<sup>111</sup> Shih, ngjashëm, *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 60

<sup>112</sup> Kërkesa Referuese, para. 26(i).

<sup>113</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 68; shih gjithashtu para. 101.

<sup>114</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 101; shih gjithashtu para. 115, 118.

<sup>115</sup> *Vendimi mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 73-85, 105-113, 115, 117.

<sup>116</sup> Shih, ngjashëm, *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 23-30; *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Qasjen në Material*, para. 17-21.

procesit,<sup>117</sup> Dhoma vlerëson se këto pohime janë hamendësuese. Sikurse u vu në dukje, procesi në Çështjen 12 vazhdon, dhe nuk është arritur ende asnjë rezultat përfundimtar.<sup>118</sup> Rrjedhimisht, Dhoma gjykon se në këtë fazë nuk mund të supozohet se parregullsitë e pretenduara nuk mund të trajtohen më vonë.

58. Në fakt, u takon së pari dhomave penale të vlerësojnë nëse pretendimi i ngritur për shkelje procedurale ka ndonjë bazë dhe nëse kjo duhet ndrequr gjatë gjykimit vijues.<sup>119</sup> Kjo pasqyron parimin e përgjithshëm sipas të cilit përmbushja e kriterëve të gjykimit të drejtë duhet të shqyrtohet në secilin rast duke mbajtur parasysht zhvillimin e procesit në tërësi dhe jo në bazë të shqyrtimit të izoluar të një aspekti të veçantë apo të një incidenti procedural të vetëm.<sup>120</sup>

59. Sa i përket ankesës së Parashtruesit se, në qoftë se pritet deri në fund të procesit për të shqyrtuar drejtësinë e tij, ndaj tij mund të zhvillohet proces panevojshëmrisht i gjatë,<sup>121</sup> Dhoma vëren se Parashtruesi ngriti pretendim për një shkelje tjetër të nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, konkretisht shkeljen e së drejtës që për akuzat penale kundër tij të vendosë një “gjykatë e themeluar me ligj” dhe jo se procesi ishte tejet i gjatë. Megjithëse ankesat në lidhje me kohëzgjatjen (e arsyeshme) do të kërkonin shqyrtimin e aspekteve të tjera, Dhoma është e mendimit se ato nuk ndikojnë në vlerësimin e argumenteve të paraqitura në këtë ankesë, pasi në këtë moment ankesa është thjesht hipotetike.<sup>122</sup>

60. Bazuar në arsyetimin e saj në lidhje me aspektin nëse Parashtruesi ka statusin e

---

<sup>117</sup> Kërkesa Referuese, para. 26(ii).

<sup>118</sup> Shih më lart, para. 52, 54.

<sup>119</sup> Shih, ngjashëm, *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 27; *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Qasjen në Material*, para. 19. Shih gjithashtu ECtHR, *Mehmet Zeki Çelebi v. Turkey*, no. 27582/07, 28 January 2020, para. 51.

<sup>120</sup> ECtHR, *Ibrahim and others v. the United Kingdom [GC]*, no 50541/08 and others, 13 September 2016, paras 250-251.

<sup>121</sup> Kërkesa Referuese, para. 26(ii).

<sup>122</sup> Shih, ngjashëm, *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 64.

viktimës, Dhoma konstaton se ankesa, në këtë fazë të procesit, është e parakohshme.<sup>123</sup>

Për pasojë, ankesa e Parashtruesit sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës duhet të shpallet e papranueshme në përputhje me nenin 113(7) të Kushtetutës, nenin 49(3) të Ligjit dhe rregullën 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

61. Së fundi, megjithëse Dhoma gjykon se ankesa duhet të rrëzohet për arsyet e lartpërmendura, ajo rikujton se, në parim, korniza ligjore e DHS-së i mundëson Parashtruesit të paraqesë, në faza të ndryshme të procesit, pretendime për shkelje të drejtave të tij në bazë të nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës. Në lidhje me këtë, Dhoma vëren se sipas nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 20(1)(a) të Rregullores së DHSGJK-së, një individ mund t'i drejtojë kërkesë referuese Dhomës vetëm pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të parashikuara me ligj kundër shkeljes së pretenduar. Sidoqoftë, duke qenë se ankesa është e parakohshme, Dhoma në këtë moment nuk është e detyruar të vendosë lidhur me kushtin e shterjes të këtyre mjeteve.

## B. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 36 TË KUSHTETUTËS DHE NENIT 8 TË KONVENTËS

### 1. Parashtrimet

62. Parashtruesi argumenton se Kërkesa Referuese është e pranueshme.<sup>124</sup> Ai pretendon se, megjithëse Dhoma e vlerësoi Kërkesën Referuese si të parakohshme në lidhje me shkeljet e pretenduara të nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, kjo nuk vlen për shkeljen e nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të Konventës që është bërë ndaj tij që në këtë fazë të procesit.<sup>125</sup> Parashtruesi argumenton gjithashtu se i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të disponueshme për shkeljen e pretenduar dhe se Kërkesa Referuese u paraqit në kohë, brenda dy (2) muajsh nga

---

<sup>123</sup> Shih, ngjashëm, *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të P. Shalës në lidhje me Pranueshmërinë e Deklaratave të Mëparshme*, para. 29.

<sup>124</sup> Kërkesa Referuese, para. 24.

<sup>125</sup> Kërkesa Referuese, para. 25, 26(iii).

vendimi përfundimtar në lidhje me aspektet e paraqitura, përkatësisht vendimi i Panelit të Apelit i 28 tetorit 2025, për të cilin ai njoftua më 29 tetor 2025.<sup>126</sup>

## 2. Vlerësimi i Dhomës

63. Fillimisht, Dhoma mban parasysh pretendimin e Parashtruesit se masat e urdhëruara nga gjykatësit Giju dhe Masëlo, në cilësinë e tyre si gjykatës të vetëm dhe gjykatës të procedurës paraprake, shkelën të drejtën e tij për respektim të jetës private dhe familjare në bazë të nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të Konventës për shkak se këta gjykatës u caktuan në mënyrë të palejueshme dhe, rrjedhimisht, masat në fjalë nuk u morën “në përputhje me ligjin”.<sup>127</sup> Sidoqoftë, Dhoma vë në dukje se, me përjashtim të referencave të përgjithshme për masa si incizimi i fshehtë i bisedave, qasja në dokumente elektronike, ose kontrollimi dhe sekuestrimi, Parashtruesi nuk identifikon vendimet apo urdhrat konkretë për të cilat ankohet dhe nuk shpjegon se si këto masa shkelën të drejtën e tij për respektimin e jetës private dhe familjare, përfshirë aspektin e veçantë të së drejtës në fjalë.<sup>128</sup> Dhoma është e mendimit se ankesa e Parashtruesit është formuluar në terma tejet të përgjithshëm dhe të vagullt që nuk bëjnë të mundur vlerësimin e saj dhe, rrjedhimisht, është e pabazë.<sup>129</sup>

64. Gjithashtu, duke qenë se ankesa e Parashtruesit sipas nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të Konventës mund të thuhet se, në thelb, bazohet në të njëjtin arsyetim të trajtuar më lart sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës, Dhoma u referohet konstatimeve të veta të mëparshme,<sup>130</sup> dhe është e mendimit se, për pasojë, kjo pjesë e Kërkesës Referuese nuk përbën aspekt të veçantë që duhet të vendoset në këtë fazë. Rrjedhimisht, Dhoma gjykon se ankesa nuk tregon për krijimin e ndonjë

<sup>126</sup> Kërkesa Referuese, para. 27-28.

<sup>127</sup> Kërkesa Referuese, para. 3, 79-84.

<sup>128</sup> Kërkesa Referuese, para. 81-83.

<sup>129</sup> Shih, për shembull, Kosovë, Gjykata Kushtetuese, *Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Rev. nr. 392/19 të 2 qershorit 2020*, KI 173/20, Aktvendim për papranueshmëri, 10 nëntor 2019 (30 nëntor 2021), para. 49, 75; ECtHR, *Trofimchuk v. Ukraine* (dec.), no. 4241/03, 31 May 2005.

<sup>130</sup> Shih më lart, para. 52-60.

perceptimi për shkelje të drejtave të Parashtruesit sipas nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të Konventës dhe e rrëzon atë sit ë papranueshme në përputhje me rregullën 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.<sup>131</sup>

65. Sidoqoftë, megjithëse Dhoma gjykon se ankesa duhet të rrëzohet për arsyet e lartpërmendura, ajo vëren se, varësisht prej masave konkrete për të cilat paraqitet ankesë, në parim, Parashtruesi mund të duhet ta ngrejë ankesën në procesin kundër tij.<sup>132</sup> Rrjedhimisht, vlerësimet e mëhershme të Dhomës lidhur me shterimin e mjeteve juridike, në paragrafin 61 të këtij vendimi, mund të jenë relevante edhe për këtë ankesë. Megjithatë, duke qenë se ankesa është e papranueshme sipas rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së, Dhoma nuk është e detyruar të vendosë në këtë fazë lidhur me kushtin e shterimit së mjeteve juridike.

### C. PËRFUNDIM

66. Bazuar në sa më lart, Dhoma rrëzon si të parakohshme, për shkak se nuk ekziston statusi i viktimës, ankesën e parë të Parashtruesit lidhur me shkeljen e pretenduar të së drejtës që për akuzat penale ndaj tij të vendosë “një gjykatë e themeluar me ligj”, sipas nenit 31(2) të Kushtetutës dhe nenit 6(1) të Konventës. Rrjedhimisht, kjo pjesë e Kërkesës Referuese duhet të shpallet e papranueshme në bazë të nenit 113(7) të Kushtetutës, nenit 49(3) të Ligjit dhe rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

67. Po kështu, Dhoma konstaton se ankesa e Parashtruesit për shkelje të së drejtës së tij për respektimin e jetës private dhe familjare sipas nenit 36 të Kushtetutës dhe nenit 8 të Konventës, për shkak të masave të autorizuara në lidhje me të, është e pabazë dhe nuk tregon për krijimin e ndonjë perceptimi për shkelje të të drejtave kushtetuese të

---

<sup>131</sup> Shih, ngjashëm, *Vendimin mbi Kërkesën Referuese të H. Thaçit lidhur me Kundërshtimin e Juridiksionit*, para. 114.

<sup>132</sup> ECtHR, *Dragojević v. Croatia*, no. 68955/11, 15 January 2015, paras 72-73; *Bălteanu v. Romania*, no. 142/04, 16 July 2013, paras 32-35.

Parashtruesit. Rrjedhimisht, edhe kjo pjesë e Kërkesës Referuese duhet të shpallet e papranueshme në bazë të rregullës 14(f) të Rregullores së DHSGJK-së.

PËR KËTO ARSYE,

Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

*Rrëzon* si të papranueshme ankesat e paraqitura nga z. Hashim Thaçi në Kërkesën Referuese.

/nënshkrimi/

**Vidar Stensland**  
**Kryegjykatës**

Hartuar në anglishte të enjten, më, 5 shkurt 2026

Në Hagë, Holandë